



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E VITISË - OPŠTINA VITINA

Pranuar - Primijseno Më/Dana 19.12.2012 vit/god.

Nr. i organit Org. broj	Numri/Broj	Shtojcë Prilog	Vlera Vendnost
01-	013	1463	



Komuna e Vitisë
Opština Vitina
Municipality of Viti/na

Ne bazë të nenit 12.2 pika d) lidhur me nenin 40.2 pika i) të Ligjit mbi vetëqeverisjen lokale nr 03/L-40 të Kuvendit të Republikës së Kosovës Gazeta zyrtare nr 28/2008, dhe nenit 35.2 pika i) të Statutit të Komunës së Vitisë 01 nr 013/491 të datës 21.04.2011 Kuvendi i Komunës së Vitisë në mbledhjen e mbajtur më 20.11.2012, aprovon këtë:

V E N D I M

PËR EMËRIMIN DHE RIEMËRIMIN E RRUGËVE NË QYTETIN E VITISË ME EMRAT E DËSHMORËVE TË UÇK-SË NGA KOMUNA E VITISË

Neni 1

Me këtë vendim, Kuvendi i Komunës së Vitisë, bënë emërimin dhe riemërimin e rrugëve në qytetin e Vitisë me emrat e Dëshmorëve të UÇK-së nga Komuna e Vitisë si vijon:

1. Rruga kryesore në hyrje të Vitisë nga Kllokoti (Zona kadastrale e Vitisë) deri te Restoranti "Lindi" emërohet me emrin e Dëshmorit Florin Maliqi.
2. Rruga e re të Restorant "Lindi" emërohet me emrin e Dëshmorit Skender Salihu.
3. Rruga të furra Antika emërohet me emrin e Dëshmorit Selami e Mehmet Ismajli.
4. Rruga që e lidh rrugën Mustafë Koka me rrugën Flaka e Janarit emërohet me emrin e Dëshmorit Remzi Xhaferi.
5. Sheshi të lumi Morava, afër stacionit të autobusëve emërohet me emrin e Dëshmorit Rashit Mustafa.
6. Rruga që vazhdon pas asaj 2 Korriku, nga rruga Hasan Prishtina në drejtim të fshatit Drobesh emërohet me emrin e Dëshmorit Muhamet Muharremi.
7. Rruga Hafiz Korça riemërohet me emrin e Dëshmorit Hebib Sejdiu.
8. Rruga Millan Shuflaj riemërohet me emrin e Dëshmorit Daut Zenuni.
9. Rruga Demokracia riemërohet e Dëshmorit Shabi Kajolli.
10. Rruga Dëshmorët e Vitisë riemërohet me emrin e Dëshmorit Xhemajl Ademi.
11. Rruga të Stacioni i Veterinës- djathtas emërohet me emrin e Dëshmorit Ylvi Demiri.
12. Rruga Dimitrije Tuceviq riemërohet me emrin e Dëshmorit Sali Zenuni.
13. Rruga e cila vazhdon pas përfundimit të rrugës Hasan Prishtina(nga ura deri te zona kadastrale e Pozhoranit) emërohet me emrin e Dëshmorëve Jeton e Naser Rama.
14. Rruga të furra Oreksi – djathtas emërohet me emërimin e Dëshmorit Mustafë Shema.
15. Rruga skaj përroskës afër agjensionit Tanamera emërohet me emrin e Dëshmorit Safet Ajeti.
16. Sheshi përballë Qendres tregtare "Press-com" emërohet me emrin e Dëshmorit të njohur Hasan Ali Remniku.

Neni 2

Me këtë vendim plotësohet vendimi i Kuvendit të Komunës së Vitisë për emërtimin e rrugëve dhe të shesheve të qytetit të Vitisë 01 nr 018/1219 të datës 28.05.2002.

Neni 3

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit e Komunës së Vitisë.

Neni 4

Ky Vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Vitisë.

Vendimi u dorëzohet:

1. Drejtorisë për Urbanizëm,
2. Në dosje të Kuvendit,
3. Arkivit

KRYESUESI I KUVENDIT
Skenderbe Hebibi

